

UDHËZUES MBI TRANSFERIMIN NDËRKOMBËTAR TË TË DHËNAVE PERSONALE



Tiranë 2014

Përshkrim

Konventa Nr. 108 e Këshillit të Evropës dhe Protokollit Shtesë “Në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”, Direktiva 95/46/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me të dhënat personale dhe lirinë e lëvizjes së tyre” dhe në përputhje me këto akte ndërkombëtare; Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar kërkojnë që kontrolluesit si rregull të transferojnë të dhëna personale në vende që garantojnë një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave.

Megjithatë, nën kushte dhe parashikime ligjore të veçanta lejohet transferimi i të dhënave në vende të treta të cilat, nuk kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave.

Niveli i mjaftueshëm i mbrojtjes së të dhënave për një shtet përcaktohet duke vlerësuar të gjitha rrethanat në lidhje me përpunimin, natyrën, qëllimin dhe kohëzgjatjen e tij, shtetin e origjinës, destinacionin përfundimtar, aktet ligjore dhe standartet e sigurisë në fuqi në shtetin marrës.

Qëllimi i këtij kuadri rregullues ligjor të vendosur në Bashkimin Evropian dhe rendin juridik shqiptar në lidhje me transferimin ndërkombëtar është garantimi i mbrojtjes së lirisë themelore për privatësi dhe përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale, duke ditur dhe qënë të vetëdijshëm për lehtësinë me të cilën të dhënat personale mund të lëvizin në rrjetet ndërkombëtare aktualisht dhe rreziqet e mundshme që mund të vijnë nga ky qarkullim informacioni ndërmjet shteteve.

Ky kuadër synon gjithashtu, garantimin që të drejtat e subjekteve të të dhënave (personat të cilëve u përpunohen të dhënat gjatë transferimit) të vazhdojnë të mbrohen edhe në rastet kur të dhënat personale të tyre të kenë dalë jashtë territorit ku garantohet një nivel i mjaftueshëm i mbrojtjes së të dhënave.

Qëllimi i këtij Udhëzuesi është të shpjegojë dhe t'u vijë në ndihmë kontrolluesve dhe subjekteve të të dhënave personale mbi marrjen e informacionit të duhur përpara realizimit të transferimit të të dhënave personale. Arritja e një niveli të përshtatshëm të mbrojtjes së të dhënave gjatë procesit të transferimit të të dhënave personale dhe ligjshmërisë në procesin e realizimit të transferimit.

1. Legjislacioni

- ✚ Konventa Nr. 108 e Këshillit të Evropës dhe Protokollin Shtesë “Në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale” është instrument ndërkombëtar me fuqi detyruese në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.
- ✚ Direktiva 95/46/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me të dhënat personale dhe lirinë e lëvizjes së tyre”.
- ✚ Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar përcakton rregullat dhe kushtet sipas të cilave mund të bëhet transferimi i të dhënave personale nga të gjithë kontrolluesit e vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ligji është hartuar në përputhje me aktet ndërkombëtare të sipërcituara. Ai gjen zbatim në të gjitha veprimet që kryhen me të dhënat personale dhe transferimin e të dhënave në rastin e këtij udhëzuesi. Ligji është i detyrueshëm për zbatim nga të gjithë institucionet publike dhe private sipas *Fushës së Zbatimit* të përcaktuar në nenin 4 të tij.

2. Çfarë është transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale

Termi “transferim ndërkombëtar” nuk është përkufizuar në Direktivën 95/46/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me të dhënat personale dhe për lirinë e lëvizjes së tyre” ose në Konventën Nr. 108 të KE “Në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”.

Përkufizimi i termit “transferim ndërkombëtar” është parashikuar në pikën 22 të nenit 3 të ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

“Transferim ndërkombëtar është dhënia e të dhënave personale marrësve në shtetet e huaja”

Transferim i të dhënave personale është, për shembull;

- Transferimi i të dhënave të klientit të një banke, për të kryer transferim monetar, tek një marrës në një vend të tretë ose;
- Transferimi i të dhënave personale nga kontrolluesi i të dhënave tek përpunuesi jashtë Shqipërisë.

Nënkupton të gjitha rastet kur një kontrollues ndërmerr një veprim për t’ia ofruar të dhënat personale një pale të tretë që gjendet në një vend të tretë.

Termi “transferim i të dhënave personale” shoqërohet shpesh me aktin e dërgimit ose transmetimit të të dhënave nga një vend tek një tjetër, për shembull; duke dërguar dokumente në letër ose elektronike që kanë të dhëna personale me postë të zakonshme ose postë elektronike.

Dispozitat specifike të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar që i referohen transferimit ndërkombëtar janë Nenet 8 dhe 9 të tij.

3. Përshkrim i përgjithshëm i neneve 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar

Një kontrollues të dhënash personale që kërkon të transferojë të dhëna personale në një vend me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, siç e parashikon legjislacioni shqiptar për mbrojtjen e të dhënave, mund ta bëjë këtë pa nevojën e autorizimit(lejes) nga Komisioneri.

Në përputhje me Nenin 8, pika 1 të ligjit, vendet me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave përcaktohen me Vendim të Komisionerit. Konkretisht, Vendimi Nr. 3, datë 20.11.2012 “Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale” i cili përditësohet në mënyrë të vazhdueshme dhe është i publikuar në portalin zyrtar të Autoritetit të Komisionerit në linkun:

http://www.idp.al/images/njoftimi/vendim_nr_3_date_20_11_2012.pdf

Ligji lejon transferimin e të dhënave personale në ato vende që nuk kanë nivel të mjaftueshëm mbrojtjeje në raste përjashtimore që përcaktohen nga Neni 8, pika 2 e tij. Në këto raste, kontrolluesi përjashtohet nga kërkesa për autorizim.

Përjashtimet konkrete nga ky ndalim i përgjithshëm për të transferuar të dhëna personale në vende “që nuk kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale” parashikohen pikërisht në paragrafin e sipërcituar.

Kujdes: Në çdo rast, për këto transferime duhet të respektohen rregullat e përgjithshme në lidhje me përpunimin e të dhënave personale të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të ligjit.

Ligji për mbrojtjen e të dhënave gjithashtu, kërkon përmbushjen e praktikave të mira për përpunimin e të dhënave personale nga ana e kontrolluesve dhe parashikon një sërë të drejtash dhe detyrimesh për subjektet e të dhënave personale.

Këto përfshijnë detyrimin për të mbledhur dhe përpunuar vetëm të dhënat që duhen dhe janë të nevojshme për realizimin e qëllimit (parimi i mjaftueshmërisë), detyrimin për të garantuar masat e sigurisë së nevojshme për të parandaluar aksesimin aksidental apo të paautorizuar tek këto të dhëna, detyrimin e mbajtjes së të dhënave për aq kohë sa janë të nevojshme për përmbushjen e qëllimit për të cilin janë mbledhur, etj.

Ligji parshikon një sërë të drejtash për subjektin e të dhënave, si e drejta për të marrë informacion në lidhje me përpunimin e të dhënave, e drejta e aksesit tek kontrolluesi (neni 12),

dhe sipas rastit, të drejtën për të kërkuar korrigjimin, fshirjen e të dhënave personale dhe për të kundërshtuar përpunimin e mëtejshëm të tyre(neni 13).

4. Paraqitja e kërkesës për marrjen e autorizimit

Kontrolluesi i të dhënave i cili kërkon të realizojë transferim të dhënash personale në vende që nuk kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave dhe në kushtet për të cilat kërkohet autorizimi i Komisionerit duhet të bëjë një kërkesë me shkrim për marrjen e autorizimit nga Komisioneri përpara realizimit të transferimit në bazë të pikës 4 të Nenit 9 të ligjit.

Në këtë kërkesë duhet të përfshihet:

- Emri i organit administrativ të cilit i drejtohet kërkesa(Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale);
- Emri dhe adresa e kontrolluesit(transferuesit të të dhënave dhe marrësit të të dhënave);
- Shpjegimi i fakteve lidhur me kërkesën;
- Shpjegime të qarta në lidhje me pretendimet;
- Data dhe firma e kërkuarit(kontrolluesi).

Kontrolluesi duhet të plotësojë, *Formularin e Aplikimit për Aprovimin e të Dhënave Personale në një Shtet që nuk ka Nivel të Mjaftueshëm të Mbrojtjes së të Dhënave nëpërmjet Autorizimit të Komisionerit*, i cili, mund të gjendet edhe në portalin zyrtar të Komisionerit www.idp.al në linkun:

http://www.idp.al/images/njoftimi/formulari_i_aplikimit_per_transferim_te_dhenash.doc

Plotësimi i Formularit ndihmon kontrolluesit që të përmbushin detyrën e tyre, në rastet kur synojnë të kryejnë transferime për të cilat kërkohet marrja e Autorizimit nga Komisioneri në lidhje me ligjshmërinë e realizimit të tij.

Formulari duhet të plotësohet dhe nënshkruhet nga kontrolluesi që kërkon marrjen e autorizimit nga Komisioneri për transferimin e të dhënave personale në një vend që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave.

Kontrolluesi i të dhënave që kërkon autorizimin për transferimin e të dhënave, duhet t'i paraqesë Komisionerit prova të përshtatshme, në mënyrë që të mund të vlerësohet ligjshmëria e transferimit të mundshëm. Kontrolluesi i të dhënave duhet të vërtetoj me dokumente ligjore që mbledhja e të dhënave është bërë në mënyrë të ligjshme, për një qëllim të ligjshëm dhe se të dhënat personale do të mbrohen në mënyrë të mjaftueshme në vendin marrës (ku kërkohet të bëhet transferimi) duke garantuar në këtë mënyrë shmangien nga abuzimi dhe keqpërdorimi i këtyre të dhënave dhe respektimin e të drejtës së subjektit për privatësi. Pas plotësimit të Formularit të nënshkruar si dhe dokumenteve në mbështetje të deklarimeve të bëra në të, ai duhet të dërgohet tek Autoriteti i Komisionerit zyrtarisht.

5. Veprime që duhet të ndërmerren nga kontrolluesi përpara realizimit të transferimit të mbrojtjes së të dhënave personale

Në vazhdim do të paraqiten disa hapa praktikë paraprak që ndihmojnë kontrolluesit e të dhënave në procesin e realizimit të transferimit të të dhënave personale.

- ✚ Kontrolluesi duhet të vlerësojë fillimisht, nëse të dhënat që do të transferohen përbëjnë ose jo të dhëna personale;

Për të bërë këtë përcaktim kontrolluesi duhet t'i referohet përkufizimit në lidhje me termin "e dhënë personale" të parashikuar në nenin 3, pika 1 të ligjit.

Nëse të dhënat që do të transferohen nuk konsiderohen të dhëna personale transferimi mund të kryhet dhe kjo nuk përbën shkelje të Ligjit nr. 9887, datë 10.08.2005 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Nëse të dhënat janë personale, kontrolluesi duhet të verifikojë para transferimit nëse të dhënat janë mbledhur dhe përpunuar në pajtim me ligjin dhe rregullat e përcaktuara në të, specifikisht nëse janë respektuar nenet 5 dhe 6 dhe nenet e tjera në lidhje me përpunimin e të dhënave dhe kriteret ligjore për përpunimin, që duhet të respektohen në çdo rast.

✚ Nëse përpara transferimit, të dhënat personale nuk janë mbledhur apo përpunuar në mënyrë të ligjshme, në përputhje me ligjin e brendshëm të zbatueshëm (ligji nr.9887, datë 10.03.2008), përpunimi nuk është i ligjshëm. Për pasojë, transferimi nuk mund të kryhet.


Pas verifikimit të përpunimit të ligjshëm ose jo, kontrolluesi duhet të verifikojë:

✚ Nëse do të transferohen të dhënat personale në një vend me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave. Për listën e vendeve me nivel të mjaftueshëm kontrolluesi duhet t’i referohet vendimit Nr. 3 të Komisionerit (sipas pikës 3 të këtij Udhëzuesi).

Nëse të dhënat transferohen tek një vend brenda kësaj liste (e vendeve me nivel të mjaftueshëm) atëherë transferimi mund të kryhet.

✚ Nëse të dhënat do të transferohen në një vend me nivel jo të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, atëherë kontrolluesi duhet të paraqesë një kërkesë për autorizim pranë Komisionerit, sipas rregullave të përcaktuara në nenet 8 dhe 9 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale (sipas pikës 4 të këtij Udhëzuesi).

Diagrama e mëposhtme paraqet në mënyrë ilustruese hapat që duhen ndërmarrë nga kontrolluesi



Ky Udhëzues përmban një qëndrim të përgjithshëm në lidhje me transferimin e të dhënave personale dhe procedurat që duhet të ndiqen nga kontrolluesit përpara realizimit të transferimit.

Duhet theksuar se, vendimmarrja e Komisionerit do të jetë gjithmonë sipas rastit konkret dhe e bazuar në specifikat karakteristike të çdo praktike dhe dokumentacionit konkret në lidhje me transferimin.

Punoi: Pjerina GAXHA



Adresa: “Rr. Kavajës, Nd. 80, H. 1, Kati 5 - Tiranë

Telefon: +35542237200

E-mail: info@idp.al

Website: www.idp.al

Tiranë 2014